

DISKUTOJMË ME GRATË DHE VANZAT E POGRADECIT,
I BËJMË ATO PARTINERË TË ALTERNATIVËS SONË!



Zonja, gra dhe vajza të Pogradecit,

Fjalën time të parë do e ndaj me JU dhe kjo nuk është aspak rastësore, është thellësisht e natyrshme.

Ne burrat, nuk mund të mos mendojmë në çdo moment se:

- * na ka lindur një grua;
- * na ka rritur një nënë;
- * kemi përkrash një bashkëshorte;
- * jemi prindërit e vajzave tona;
- * si dhe kemi kaq e kaq kolege me të cilat bashkëpunojmë.

Gra dhe vajza të Pogradecit,

Kemi disa qindra orë në dispozicion, për të bërë një fushatë dinjitoze, me program dhe strategji të qartë zhvillimi, të kalkuluar mirë në kohë dhe në kosto.

Kemi disa qindra orë, për të trokitur në derën, në mendjen dhe në zemrën e gjithkujt; dhe për të bërë çdo banor që të na e hapë derën, të na japë mendjen dhe të na pranojë me zemër.

Prezenca juaj, në transformimet social-ekonomike, është jetike!

BASHKË PËR POGRADECIN